



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr.19, datë 03.10.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT VODAFONE ALBANIA,  
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 3 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA:  
1231 KRUTJE 2, 1232 BERAT 3, 1248 ELBASAN CNR 2”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit Vodafone Albania, nëpërmjet shtimit të antenave për 3 stacione bazë të emërtuara: 1231 Krutje 2, 1232 Berat 3, 1248 Elbasan CNR 2”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vodafone Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkive Lushnje, Berat dhe Elbasan.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

